



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 219 prot.

Tiranë, më 27/01/2026

V E N D I M

Nr. 19, Datë 27/01/2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.85 Regj, datë 07.04.2025, paraqitur nga pala ankuese znj. F.K , përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 561 rep dhe nr. 210 kol, datë 15.03.2025 nga Avokat G.R kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale², me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron ndër të tjera :

Ankuesja Dr. F.K është mjeke “onkologe”, e specializuar në onkologji, me gradën shkencore “Doktore e Shkencave” në vitin 2020, pedagoge me kohë të plotë në lëndën “Onkologji”, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, prej muajit tetor 2023, si dhe mjeke “onkologe-pedagoge” në Shërbimin Onkologjik, QSUNT, me kontratë shërbimi nr. prot 2266/3, datë 12.12.2023 me QSUNT. Ka kryer edhe një sërë kualifikimesh e trajnimesh vijuese në fushën e onkologjisë dhe subspecializime në radioterapi.

Faza e parë : Periudha 2021 e vijim:

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Ndryshuar emërtimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Përgjegjësi i njësisë së radioterapisë O.S, me sjelljen e tij arbitrar, me dhunë verbale, psikologjike të përsëritur dhe fizike ndaj ankueses ka krijuar një situatë të papranueshme në punë për ankuesen. Ankuesja në lidhje me këtë situatë i është drejtuar drejtoreshës së përgjithshme të QSUNT-së zj.A.F, me ankesë datë 04.03.2024. Në vijim të kësaj ankese u mbajt një mbledhje e zgjeruar pune për të sqaruar sjelljen e mjekut O.S ndaj ankueses dhe për të ndaluar veprimet e tij arbitrar. Mbledhja përfundoi duke e nxjerrë drejtoresha e përgjithshme këtë subjekt jashtë nga zyra, pasi reagimet e tij ishin të papranueshme.

Situata diskriminuese që vijon në vendin e punës ndaj ankueses:

- Ankuesja nuk mund të marrë më pjesë në mbledhjen e stafit, për shkak të mënyrës krejt të papërshtatshme, që mjeku OrO.S i drejtohet;
- Me pusullat e letrave me kufizimet e orarit, të vendosura nga ky subjekt (pa miratimin e drejtueses së shërbimit apo të QSUNT dhe të pambështetura në rregulloren e QSUNT apo PAI Onkologjik), krijohen pengesa që nuk lejon t'iu shërbejnë pacientëve sa herë ata kanë nevojë. Në një rast të tillë, ankuesja është nxjerrë forcërisht me dhunë nga zyra, pse po punonte me fizikantët për një plan trajtimi të një pacienti (çështje që po ndiqet penalisht nga Prokuroria)
- Mjeku O.S që është theksht një mjek me specialitetin “imazherist”, vijon vulos me titullin “Onkolog” dhe kjo është një paligjshmëri e rëndë, mbi kartelat e pacientëve.
- Për mjekët dhe stafin, që e kanë kundërshtuar me argumente për sa sipër përdor termat “llumi” etj, ngjarje për të cilën, punonjësit kanë lëshuar deklaratat noteriale përkatëse.

Pra, punëdhënësi QSUNT lejon, që ankuesja të diskriminohet në vendin e punës, nga një përgjegjës njësie, që nuk është as i specialitetit “Onkolog” dhe as mjek pedagog.

Me ndryshimin e drejtimit të QSUNT, ankuesja i është drejtuar sërish me dy kërkesa me shkrim dt 30.04.2024, 29.05.2024 dhe QSUNT me shkresën e saj nr.675/8 prot datë 13.06.2024 është përgjigjur në mënyrë sfiduese, që duhet ta provojë ankuesja diskriminimin që është kryer ndaj saj. Sigurisht që kërkesat e ankueses, i ka patur dhe i ka me prova të plota shkresore si dhe me dëshmitarë për situatat e papranueshme në punë. Pra, pa zhvilluar ndonjë hetim administrativ substancial për gjendjen në njësinë RT, nëse janë marrë masa nga ana e Drejtueses të Onkologjisë që ankuesja të marrë pjesë në vizitën e përgjithshme apo vijon të jetë e izoluar, si dhe a vijnë kufizimet e orarit për t'iu shërbyer pacientëve etj., QSUNT përgjigjet se barrën e provës e ka ankuesja. Barra e provës qëndron e varur në muret dhe në dyert e Radioterapisë, por QSUNT nuk mund ti shohë sepse duhet të pranojë që për më shumë se 1 vit ka heshtur para një paligjshmërie që jo vetëm ka diskriminuar ankuesen, por ekziston dyshimi i arsyeshëm që të ketë cenuar dhe cilësinë dhe sigurinë e punës në RT, për sa kohë mjekë jo specialistë marrin vendime trajtuese për pacientët me kancer. Gjithashtu për shqetësimet e tjera të ngritura nga ankuesja se duhet të zbatohet urdhrat e një personi/subjekti, që nuk është i specialitetit onkolog dhe kjo ka pasojë në trajtimin e pacientëve i japin një përgjigje të paverifikueshme dhe të pashoqëruar me akte provuese. Situata e tillë është e paprecedentë në QSUNT ose QSUNT do ketë barrën e provës që një mjek jo specialist merr vendime dhe bën organizime në shërbime të tjera në QSUNT si në Shërbimin Onkologjik.

Faza e dytë: 25 nëntor 2024 e vijim:

Nga Drejtoria e QSUNT është miratuar urdhri i brendshëm nr.556, datë 25.11.2024 “*Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinore/tumor-bordeve në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza*”, me të cilin ankuesja është renditur me një specialitet, që nuk e ka dhe nuk ekziston, me qëllim për ta përfshirë në mënyrë të kamufluar edhe mjekun/subjektin O.S, i cili nuk ka specializimin për onkologji. Ankuesja ka specialitetin “onkologji” dhe jo radioterapute. Për këtë qëllim i është drejtuar QSUNT me shkresat nr.2938 prot dhe nr. 2938/1 prot, të datës 05.12.2024 ku është kërkuar anulimi/pezullimi i urdhrit të mësipërm për pjesën e ankueses, pasi:

- i vendoset një specialitet që nuk e ka;
- duhet të renditet si mjekë onkologë për fushat e saj të ekspertizës dhe jo së bashku me disa mjekë klinikistë jo onkologë, të cilët duhet të determinojnë për vendimarrjet e specialitet të saj.

Nga QSUNT është kthyer përgjigje me shkresën e tyre nr.2938/2 prot., datë 11.12.2024, që nuk pranohet ankimi i saj. Ky urdhër që vijon të jetë në fuqi, krijon diskriminim në punë për këto arsye:

- i) Detyrohet të marrë mendimin e një mjeku i cili nuk ka specialitetin staf përkatës, ka specialitetin imazheri dhe për vendimarrje onkologjike edhe në këto borde;
- ii) Nëse specialitetet e tjera përfaqësohen nga një person konkret dhe çdo specialitet drejtohet nga mjekë onkologë, ndërsa për onkologjinë u ndoq sqandard tjetër dhe ankuesja duhet që të vendos kolegjalisht me persona që sipas urdhrit të brendshëm nr.218, datë 23.07.2019 “Mbi mënyrën e ofrimit të shërbimeve të konsulencave terciare në QSUNT” nuk mund të jenë në vizitat e para por propozohen në stafe multidisiplinare madje dhe me mjekë që nuk janë as onkologë.
- iii) Nga ana e QSUNT ankuesja u vendos në kushte të diskriminimit në kushtet e mungesës së plotë të hetimit administrativ, lidhur me incidentet e dhunës, duke e vendosur ankuesen në të njëjtin staf;
- iv) Në “Urdhrin e Brendshëm” nr.556, datë 25.11.2024, “*Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinor/tumor bordeve*”, mungon vendosja e mjekëve pedagogë me mjekë të tjerë të shërbimit si në rastin e onkologjisë, madje kjo është vetëm në rastin e ankueses pasi për dy mjekët e tjerë pedagogë në onkologji kjo nuk ka ndodhur.

Po ashtu në brendi të Shërbimit Onkologjik, që është pjesë e QSUNT (shërbim spitalor universitar terciar) ku ankuesja dhe të tjerë bëjnë punë akademike me studentët e fakultetit, secili mjek pedagog kryeson një njësi sipas strukturës organizative të QSUNT, ankuesja sërish është e përjashtuar nga kjo mundësi, si dhe kushtet e punës janë të vështira, nëse pedagog-mjekët e tjerë, në shërbim kanë zyrat e tyre për të ushtruar aktivitetin, ankuesja ka veç një tavolinë në një zyrë masive me mjekë të tjerë klinikistë, jo-pedagogë, duke u trajtuar nga Drejtuesit e Onkologjisë në kushte të disfavorshme krahasuar me çdo staf pedagog në QSUNT.

Ankuesja shkresërisht ka kërkuar informacion drejtueses së QSUNT, se cili subjekt/mjek/administratë i ka propozuar bordet, mbi cilat kriteret, etj., dhe mbi këtë rrethanë është refuzuar mundësia të njihet në thelb me sa sipër, duke mos patur asnjë përgjigje dhe asnjë informacion të dhënë nga QSUNT. Kjo vërtetohet me shkresën kthim përgjigje nr.2938/2 prot datë 11.12.2024 në të cilën nuk ka patur asnjë dokumentacion bashkangjitur.

Faza e tretë: 24 janar 2025 e vijim:

Që në fund të muajit nëntor 2024, MSHMS ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me Sheba Medical Center për të asistuar shërbimin onkologjik. Në zbatim të kësaj marrëveshje kanë filluar bordet e bashkëpunimit, por konstatohet se ankuesja, që është pedagoge e onkologjisë dhe mjekë me këtë specialitet në shërbim nuk është përfshirë, duke përfshirë në mënyrë arbitrare mjekë-jopedagogë të specialitetit të “onkologjisë”. Pra, në bordet e bashkëpunimit janë përfshirë të gjithë mjekët pedagogë të shërbimit të onkologjisë dhe vetëm ankuesja është lënë jashtë. Vendimarrjet e këtyre bordeve janë të rëndësishme për vijimin e punës në shërbimin e onkologjisë.

Kjo gjendje diskriminuese është krijuar nga Drejtuesit e Shërbimit të Onkologjisë dhe QSUNT për të determinuar vendimarrjet, nga personat e privilegjuar të jo-specialitetit onkolog dhe jo-pedagog, të cilët, i kanë promovuar në detyrë drejtuese. Mirëpo mjekësia nuk mund të jetë një çështje dëshirash, ajo është një shkencë dhe si e tillë ka ligjësitë e saj. Në këtë kuptim nuk mund të tolerohet krijimi i situatave të tilla, jo vetëm diskriminuese, por edhe me pasoja në trajtimin e pacientëve.

Ankuesja paraqet këtë ankesë pranë Komisionerit duke pretenduar se, gjatë 4-5 viteve të fundit në QSUNT ka përjetuar shqetësime të vazhdueshme që lidhen kryesisht me marrëdhëniet e punës me kolegë dhe me drejtues të PAI Onkologjik, por situata e diskriminimit e pretenduar nga ankuesja ka precipituar për shkak të ankesave të vazhdueshme dhe të ligjshme në drejtim të përgjegjësit të njësisë së Radioterapisë O.S në lidhje me specializimin profesional të këtij subjekti, ankesa të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë shteruese nga QSUNT duke vendosur në pozita të padrejta, të pafavorshme, të pabarabarta dhe diskriminuese në kundërshtim të hapur me parimet themelore të Kodit të Punës, Kodit të Procedurave Administrative dhe rregulloreve që normojnë procesin e punës dhe proceset e rregullta ligjore.

Sa parashtruar në këtë ankim, ankuesja provon me prova shkresore që është ekzpozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, për të gjitha rrethanat që ka parashtruar dhe kërkesat/ankesat drejtuar QSUNT.

Nëpërmjet ankesës së paraqitur, ankuesja provon se është diskriminuar në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*” për trajtim të pafavorshëm, të padrejtë dhe të pabarabartë, duke cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën e saj për punësim dhe të drejtën e saj për të paraqitur ankesa, duke e penguar në ushtrimin e të drejtës ligjore të ankimit, duke mos trajtuar dhe nënshtruar shqyrtimeve administrative të kërkesave/ankesave të paraqitura nga vet ankuesja, si dhe duke penguar të drejtën

e saj në ushtrimin e rrugëve ligjore duke mos kthyer apo vendosur në dispozicion të saj dokumentacionet e kërkuara nëpërmjet shkresave dhe ankesave të paraqitura pranë QSUNT, duke shkaktuar nga QSUNT diferenca në trajtim, e cila duhet të gëzojë mbrojtje nga diskriminimi dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se ankuesja e mbart këtë shkak.

Ankimi i paraqitur nga ankuesja gjen mbështetje gjithpërfshirëse bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet në zbatim, ligjin *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* gjithashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare dhe konventa të cilat janë të ratifikuara edhe nga Republika e Shqipërisë.

Ankuesja ka pretenduar situata diskriminuese nga QSUNT dhe subjekte të tjera, përgjatë 5 viteve të fundit, situata të cilat ankuesja ka përjetuar shqetësime të vazhdueshme që lidhen kryesisht me marrëdhëniet e punës, me kolegët deri në ushtrimin e dhunës fizike dhe dhunës psikologjike, në mënyrë të përsëritur, dhe situata e diskriminimit në ambientin e punës ka precipituar, pas ankesave të paraqitura prej saj në drejtim të subjekteve ndaj të cilëve janë drejtuar këto ankesa.

Janë këto ankesa të cilat kanë sjellë për pasojë diskriminimin dhe sjellje të padrejtë dhe të pafavorshme ndaj ankuses, në kundërshtim të hapur me parimet themelore të Kodit të Punës, Kodit të Procedurave Administrative, Rregulloreve që normojnë procesin e punës në institucionet spitalore.

Bazuar në analizën e mësipërme rezulton e provuar se ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë gjithë kohës së punës për shkak të ankesave të kryera prej saj ndaj subjekteve për të cilët është parashtruar ankesa, të cilat janë finalizuar me aktin administrativ.

Ekzistenca e marrëdhënieve konfliktuale dhe klimës jo pozitive midis ankuses dhe përgjegjësit të njësisë së radioterapisë apo dhe drejtuesve të PAI Onkologjik, si dhe QSUNT, të cilët me neglizhencën e tyre dhe mos trajtimin e kërkesë/ankesave të paraqitura nga ankuesja, rezulton e provuar që ka ekzistuar që para se ankuesja të paraqiste ankesën e saj në datën 04.03.2024 drejtuar QSUNT mbi paligjshmëri në ushtrimin e profesionit të onkologut pa specializimin përkatës të subjektit O.S. Ka qenë pikërisht fakti se QSUNT nuk ka marrë asnjë masë për të adresuar shqetësimet e pretenduara nga ankuesja, përkundrazi në përgjigjen e saj ka legjitimuar paligjshmërinë e referuar nëpërmjet ankesave. Ankuesja i ka parashtruar në disa raste këto rrethana, si në lidhje me problematikën e saj në vendin e punës dhe ushtrimin e profesionit.

Për këto ankesa ka marrë dijeni si drejtuesit e institucionit të QSUNT, ashtu edhe MSHMS, gjithashtu edhe Shefja e Shërbimit të PAI Onkologjik, të cilët në mënyrë vazhduese jo vetëm që nuk kanë parashtruar zgjidhje për këtë situatë, por në shkelje flagrante të ligjit, vendosin në pozita të pafavorshme ankuesen, qoftë për ankesat që janë paraqitur, qoftë edhe për aktet administrative të lëshuara nga QSUNT të cilat dukshëm janë në kundërshtim me ligjin, por edhe vendosin në situatë diskriminuese dhe të pafavorshme ankuesen.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve, në lidhje me ankesat e paraqitura nga ankuesja rezulton se të gjitha veprimet administrative të realizuara nga ankuesja drejtuar institucioneve QSUNT, MSHMS, institucione që mund të ndjekin në mënyrë administrative ankesat e parashtruara nga ankuesja, shkresa dhe përgjigje nga institucionet, të cilat bashkëngjiten këtij ankimi së bashku edhe me prova të tjera, si dokumentacion provues dhe tregues, duke renditur si më poshtë:

- Shkresë dt.04.03.2024 dërguar QSUNT;
- Email-i dt. 05.03.2024 drejtuar shefit të shërbimit dhe drejtuesit mjekësor;
- Kopje e faqes web për përgjegjësin e njësisë së RT ku tregohet specializimi Imazheri;
- Kopje e vulës së mjekut O.S;
- Shkresë dt. 30.04.2024 drejtuar QSUNT;
- Shkresë dt. 29.05.2024 drejtuar QSUNT, Kryeministrit të Republikës, Ministrisë së Shëndetësisë, Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë;
- Kërkesë për vënie në dispozicion kopje dokumentacioni dhe informacion në lidhje me zbatimin për shkresën e datës 30.04.2024 drejtuar QSUNT;
- Kthim përgjigje nr.675/8 prot, datë 13.06.2024 nga QSUNT;
- Kthim përgjigje dt. 11.07.2024 shkresë me nr.675/8 prot datë 13.06.2024 drejtuar QSUNT;

Me provat e mësipërme provohen plotësisht rrethanat e parashtruara në ankim.

Ankuesja nëpërmjet ankimit të paraqitur, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e mësipërme, si dhe të gjitha provat që i bashkangjiten ankimit, si dhe ato që do të administrohen, krijohet bindja e plotë se sa më sipër pretenduar dhe provuar, sjellja dhe veprimtaria e subjekteve ndaj të cilëve paraqitet ky ankim, jo vetëm që është e pabazuar dhe disproporcionale, por është pasojë negative që ka ardhur si rezultat i paraqitjes së ankesave, duke përfshirë pretendimet për diskriminim, pranë QSUNT dhe MSHMS, nga ana e ankueses kundër përgjegjësit të njësisë së RT.

Në bazë të nenit 35, të LMD, QSUNT nëpërmjet drejtuesve të saj, Drejtorë Mjekësorë dhe Shefja e Shërbimit të PAI Onkologjik, mban përgjegjësi individuale që me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë lejuar moszbatimin e ligjit dhe procedurave të posaçme, të cilat janë përgjegjësi e drejtuesve të institucionit, duke e ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Ankuesja është diskriminuar nga ana e drejtorisë së QSUNT dhe PAI Onkologjik, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes së ankesës, duke shkelur ndalimin e diskriminimit sipas parashikimeve të nenit 3, pika 1 e17 dhe nenit 5, pika 1 të LMD.

Të gjitha veprimet dhe mosveprimet në shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi bazën e të cilave normohet dhe rregullohet veprimtaria në një institucion spitalor publik, nga ana e drejtuesve të QSUNT dhe PAI Onkologjik, duke përdorur organet e këtij institucioni kanë krijuar një klimë dhe një mjedis armiqësor ndaj ankueses, duke e bërë atë objekt të veprimeve të

paligjshme ndaj saj, kjo për shkak të ankesave të paraqitura në lidhje me paligjshmëritë nga ana e saj.

Në vijimësi ankuesja është shqetësuar dhe kërcënuar në vendin e saj të punës, dhe gjithashtu nuk rezulton të jetë ndërmarrë ndonjë procedurë për verifikimin e tyre, qoftë edhe për të konkluduar se pretendimet e saj kanë qenë të pabaza. Në momentin që ankuesja ka kundërshtuar duke mos pranuar sjelljet e padëshiruara dhe të papërshtatshme në vendin e punës, ajo është vendosur në kushte të disfavorshme dhe përballë “organizimeve” të zhvilluara në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi dhe duke cenuar të drejtën e ankueses për të patur akses të ligjshëm në aktivitete mjekësore.

Sa më sipër, provohet plotësisht se ankuesja është diskriminuar në formën e shqetësimit dhe ka munguar plotësisht marrja e masave nga ana e punëdhënësit QSUNT, të cilët kanë shkelur ndalimin e diskriminimit sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 e 13 dhe nenit 5, pika 1 të LMD.

Konstatohet dhe provohet që nga ana e QSUNT, nuk rezulton të jenë marrë masat e duhura për të trajtuar në mënyrë efektive ankesat dhe shqetësimet e paraqitura nga ana e ankueses në ankesat e saj drejtuar këtij institucioni.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të ankueses dhe marrjen e masave të mëposhtme:

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses Dr.F.K .
- Ndërprerjen e diskriminimit në punë për ankuesen, duke u mundësuar kryerja e aktivitetit akademik dhe klinik, pa pengesa në shërbim, me pozitë të njëjtën juridike me mjekët e tjerë pedagogë;
- Detyrimin e QSUNT të trajtojë në mënyrë efektive ankesat e paraqitura nga ankuesja dhe dhënia e informacioneve të nevojshme, të kërkuara rregullisht nga ankuesja.
- Marrja e masave konkrete nga ana e QSUNT për të ndaluar çdo lloj forme vendimarrje nga stafi jo onkologë i pranishëm në Shërbimin e Onkologjisë.
- Marrja e masave konkrete nga ana e QSUNT për të ndaluar çdo lloj forme vendimarrje nga stafi jo onkologë i pranishëm në onkologjikë, për të siguruar zbatimin e misionit të QSUNT...
“ Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciare) për të gjithë territorin e vendit dhe shërbim mjekësor dytësor për Tiranën, të shërbejë me profesionalizëm duke respektuar rregullat e deontologjisë dhe të etikës mjekësore.. ”

Pala ankuese parashtron se vetëm episodi traumatik i dhunës fizike që drejtuesi i njësisë O.S duke kapur me forcë nga krahu për të nxjerrë nga zyra ku punonte me fizikanten për trajtimin e një pacienti, është për hetim të mëtejshëm në Prokurori.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar(LMD), parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në referencë të kësaj dispozite ligjore, rezulton se shkak i pretenduar nga ankuesja, *gjendja arsimore*, është shkak i mbrojtur, i parashikuara shprehimisht nga ligji, ndërkohë që nga ana tjetër, lista e shkaqeve të mbrojtura sipas nenit 1, të LMD nëpërmjet parashikimit “*ose me çdo shkak tjetër*”, është një listë e hapur shkaqesh..

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), mbrojtja nga diskriminim garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

LMD, garanton mbrojtje nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12, pika 1, gërma c, të LMD, sanksionohet se: *“1. Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të ligjit.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 577/2 prot., datë 24.04.2025, Komisioneri njoftoi palët, për fillimin e procedurës administrative, duke kërkuar parashtrime dhe informacion në lidhje me çështjen nga ana e QSUNT-së, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr. 431/2 prot., datë 08.05.2025, ka kthyer përgjigje QSUNT, duke parashtruar ndër të tjera se:

Znj. F.K ka paraqitur pranë QSUNT ankesat administruar me shkresat me nr. 675/6 dhe nr 675/7 prot, datë 31.05.2024, në të cilat është kërkuar si më poshtë vijon:

1. Kërkohet të merren masa të menjëhershme për të ndaluar veprimet dhe sjelljet diskriminuese dhe të tjera të paligjshme, me pasoja për jetën dhe shëndetin e pacientëve dhe të stafit, të shkaktuara nga përgjegjësi i njësisë O.S, në vendin e punës;
2. Përmbushja e kushteve të punës për kërkuesen, bazuar në kontratën e shërbimit me QSUNT-në;
3. Kufizimin e aktivitetit klinik të mjekut O.S, në mungesë të specializimit dhe licencës së ushtrimit të profesionit si mjek onkolog, lëshuar nga UMSH.

me anë të të cilave referohet kërkesa për verifikim nga ana e QSUNT, për sa më poshtë vijon:

4. Të kryhet një këqyrje në shërbim nëse përgjegjësi i njësisë vulos me vulë ndryshe nga specialiteti i tij, e cila mund të konsiderohet deri në kufijtë e falsifikimit.
5. A janë të pabazuara në ligj dhe në rregulloren e QSUNT dhe burim abuzimi deri në korrupsion oraret kufizuese të vëna në shërbim.
6. A janë krijuar pengesa fiktive për pacientët arbitrarisht nga mjeku O.S për t’u vendosur në trajtim dhe është dashur ndërhyrje nga lart, që të lejohen mjekët specializantë t’iu shërbejnë pacientëve.
7. A është e mundur të marrë pjesë në mbledhje Dr.F.K , apo duhet të vijojë e izoluar në përgjegjësi sa herë e sheh e fyen dhe i drejtohet në mënyrë arrogante.
8. Dhe së fundi, por jo nga rëndësia, a mund të drejtojë një njësi si RT, një mjek pa specialitetin përkatës? Ndoshta këtu e ka gjenezën gjithë sjellja e papërshtatshme e mjekut O.S ndaj kërkueses, duke konsideruar Dr. Krajën si të vetmen pengesë për të vijuar aktivitetin e tij, i cili të krijon të gjitha dyshimet e arsyeshme që është në kundërshtim me ligjin dhe me rregulloren e QSUNT.

Me shkresën nr. 675/8 prot datë 13.06.2024 nga ana e QSUNT i është kthyer përgjigje referuar ankesave të paraqitura dhe bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, neni 77 e vijues, organi publik ka marrë në shqyrtim të gjitha dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e këtij hetimi administrativ, në mënyrë të plotë dhe shteruese.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, ka përcjellë pranë Shërbimit Onkologjik të gjitha ankesat e depozituara nga Përgjegjësi i Njesisë së Radioterapisë (Akselerator+Rrezatim Kobalti) dhe mjeku pedagog DSHM F.K , sa i përket çështjeve që i përkasin organizimit të brendshëm të shërbimit, mbështetur në përshkrimin e punës së shefit të shërbimit, në rregulloren e funksionimit dhe akt marrëveshjen e shefit të shërbimit, të tilla si: vulosja e kartelave, vendosja e orareve kufizuese, organizimi i mbledhjeve të njesisë, ndarja e detyrave, respektimi i rregullores së QSUNT dhe Kodit Etik të punonjësve të QSUNT dhe Kodit Etik Deontologjik Mjekësor, etj, të cilat rregullohen edhe nëpërmjet rregullores së brendshme të shërbimit.

Nga hetimi administrativ në lidhje me procedurën e zhvilluar nga QSUNT për pozicionin e Shefit të Njesisë së Radioterapisë, ka rezultuar si më poshtë vijon:

- Pranë QSUNT është depozituar kërkesa me nr.137 prot datë 20.03.2029 me objekt “Kërkesë për plotësim të vendit vakant të Përgjegjësit të Njesisë së Radioterapisë në Shërbimin Onkologjik të Shefit të Njesisë së Radioterapisë”, bazuar në strukturën e miratuar të PAI të Spitalin Onkologjik.
- Memo me nr.1556 prot, datë 12.04.2019 me lëndë “Informacion lidhur me vendin e lirë Përgjegjës Njësie në Njësinë e Radioterapisë (Akselerator + Rrezatim Kobalti të Shërbimit Onkologjik, PAI i Spitalit Onkologjik”.
- Urdhër nr.1556/1 prot., 12.04.2019 për shpallje konkursi për pozicionin 1 përgjegjës njësie, pranë njesisë së radioterapisë (akselerator + rrezatim kobalti) në shërbimin onkologjik, në polin e administrimit të integruar të spitalit onkologjik në QSUNT.
- Shkresën me nr.1556/2 prot datë 12.04.2019 me lëndë “Dërgim për shpallje vend të lirë pune” drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, për shpalljen e njoftimit në numrin e radhës së Buletinit të Njoftimeve Publike, së bashku me kriteret dhe listën e dokumenteve të cilat duhet të përmbushin kandidatët e interesuar.
- Vendimi nr.371 datë 23.05.2019 për ngritjen e Komisionit *Ad Hoc* dhe zhvillimin e konkursit datë 24.05.2019 për pozicionin 1(një) përgjegjës njësie pranë Njesisë së Radioterapisë (Akselerator Rrezatim Kobalti, në Shërbimin Onkologjik, pranë Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Onkologjik në QSUNT.
- Ka rezultuar që për këtë pozicion ka shprehur interes Dr. O.S dhe në përfundim të konkursit kandidati është vlerësuar me 36 pikë.

Referuar nenit 81, të Kodit të Procedurave Administrative, organi publik vlerëson se procedura e ndjekur për pozicionin e përgjegjësit të njësisë RT, është në përputhje me legjislacionin në fuqi, bazuar në dokumentet, si dhe vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, pjesë e dosjes së kandidatit Dr. O.S .

Në lidhje me pretendimet që ankuesja parashtrohet për sjellje diskriminuese të përgjegjësit të njësisë Dr. O.S kundrejt saj, kërkueses i është kërkuar të paraqesë prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim pasi deri në këto momente ato mbeten në kuadrin e pretendimeve.

Këtë qëndrim e bazojmë në nenin 17 të Kodit të Procedurës Administrative, ku përcaktohet qartë se organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. Në të referohet qartë rastet kur trajtimi përbën diskriminim, si dhe faktin që palët nuk janë në situata të njëjta objektive, për shkak të hierarkisë në ushtrimin e detyrës, çka e bën atë një trajtim të diferencuar dhe që lidhet me përgjegjësitë dhe ushtrimin e detyrave sipas pozicionit përkatës.

Më tej, referuar dokumentacionit të administruar, ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës (kur barra e provës i bie kërkuesit) dhe në rastin objekt shqyrtimi, referuar parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative, neni 82 (Barra e provës) pika 1, barra e provës i bie kërkuesit.

Në lidhje me pretendimin se përgjegjësi i njësisë vulos me vulë ndryshe nga specialiteti i tij, ka rezultuar i pambështetur në fakte dhe prova, pasi referuar verifikimit të bërë, shkresës së shefit të shërbimit të administruar me nr.675/5 prot., datë 13.05.2024, si dhe dosjes personale të Dr. O.S , i cili ushtron aktivitetin referuar licencës dhe specialitetit për imazherik, onkologji dhe radioterapi, si dhe marrëdhëniet e punës pranë QSUNT, i cili ka filluar si Mjek Radioterapeut Onkolog. referuar specimenit të vulës së administruar si pasojë e hetimit administrativ, rezulton se në vulë përshkruhet ndër të tjera të dhënat “Onkolog – Radioterapeut”, e cila rezulton në përputhje me emërimin fillestar pranë QSUNT në fillimin e marrëdhënies së punës si Mjek- Radioterapeut – Onkolog, Licencën për ushtrimin e profesionit si dhe specializimin përkatës.

Në lidhje me pretendimin se Dr.O.S , në cilësinë e përgjegjësit të njësisë së radioterapisë, ka kryer akte dhune verbale dhe fizike në vendin e punës ndaj kërkueses, në mënyrë që ta pengojë të kryejë shërbimin ndaj pacientëve dhe prishje të imazhit të saj profesional, kërkuesja ka kryer kallëzim penal dhe po vijojnë procedurat gjyqësore në ngarkim të z.O.S , sqarojmë se:

Neni 66 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton se, nëse organi publik që zhvillon procedurën administrative përballat me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një shkelje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën

administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

Bazuar në sa më sipër, si dhe nga sa deklarohej, veprimet e Dr. O.S janë tashmë objekt hetimi dhe i takon organeve hetimore të realizojnë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi faktet penale të referuara nga kërkuesja, nëse ato ekzistojnë dhe përbëjnë apo jo fakt penal në kuptim të legjislacionit penal. Për këtë arsye, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake, QSUNT do të pezullojë procedurën për sa i përket këtij pretendimi.

Në lidhje me pretendimet për çështje që i përkasin organizimit të brendshëm dhe shërbimit, mbështetur në përshkrimin e punës së shefit të shërbimit, në rregulloren e funksionimit dhe akt marrëveshjen e shefit të shërbimit të tilla si, vulosja e kartelave, vendosja e orareve kufizuese, organizimi i mbledhjeve të njësisë, ndarja e detyrave, respektimi i rregullores së QSUNT dhe Kodit të Etikës të punonjësve të QSUNT, Kodit Etik Deontologjik Mjekësor dhe në rregulloren e brendshme të shërbimit, në lidhje me pretendimet e Dr. F. Kraja, sjellim në vëmendje shkresën nr.835/3 prot., datë 16.05.2024 të Shefit të Shërbimit të PAI Onkologjik ku ndër të tjera shprehimisht citon: *“Ndërkohë Dr. F. Kraja, me apo pa arsye të shpjeguara, nuk njeh Dr. O.S. në si Përgjegjës i emëruar me procedurë të Njësisë së Radioterapisë, dhe për rrjedhojë anashkalon çdo urdhër apo organizim të tij në lidhje me mbarëvajtjen e punëve në këtë Njësi duke mos marrë pjesë në asnjë prej mbledhjeve që Dr. S. organizon me stafin nën varësi.”*

Lidhur me ankesën të cituar *“Faza e dytë: 25 nëntor 2024 e në vijim”* si dhe shkresat e ankueses të administruara në QSUNT me nr.2938 prot dhe nr.2938/1 prot., datë 05.12.2024 me objekt *“Anulimin e menjëhershëm dhe pjesërisht të aktit administrativ Urdhër i Brendshëm Nr. 556, dt. 25.11.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisciplinore/tumor bordeve”* në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, për kërkuesen Dr. F.K , ku janë parashtruar pretendimet e kërkueses për sa i përket bordeve multidisciplinore në të cilat ajo është caktuar të jetë e pranishme dhe specifikisht:

1. Bordi multidisciplinor për shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme Digjестive nr.3 O.S/Dr.B.Sh/F.K ; Mjekë Radioterapeut
2. Bordi multidisciplinor për shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme nr.1, F.K /Dr.B.Sh; Mjeko Radioterapeut
3. Bordi multidisciplinor për shërbimin e urologjisë, O.S/F.K /B.J; Mjeko Radioterapeut

Pretendimet e paraqitura prej saj, lidhen me problematikat dhe pengesat e krijuara mes saj dhe mjekut O.S. Ankuesja shprehet se në urdhrin e sipërcituar përdoren emërtime të cilat nuk ekzistojnë në diplomën e specializimit të Dr. F.K . Dr.F.K është mjeko Onkologe, punësuar si mjeko onkologe, pra specialiteti Radioterapeut është term që nuk përmbahet në diplomën e specialitetit të saj dhe në licencën e saj. Specializimet dhe trajnimet e saj në fushën e radioterapisë plotësojnë

specialitetin në onkologji, por nuk ndryshojnë specialitetin e tyre. Ky term (titull) nuk ekziston dhe nuk përfaqëson asnjë nga stafi i onkologut.

Edhe në stafin e neurokirurgjisë rezultojnë të njëjtat mjekë deklarohen 2 herë, një herë si onkologë dhe një herë si radioterapeut, pra në një staf multidisciplinar mjekët onkologë bëjnë konsultime të plota onkologjike dhe në stafet e tjera të konsultimit të propozohen të përgjysmuara.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkohet të bëhet i ditur subjekti i cili ka propozuar urdhrin e brendshëm për stafet multidisciplinare për stafin e onkologjisë, pasi stafet multidisciplinare përmbajnë përfaqësues nga çdo shërbim dhe nga shërbimi onkologjik përmbajnë 5-6 mjekë onkologë të niveleve të ndryshme të ekspertizës.

Me anë të kësaj kërkesë, ankuesja ka kërkuar të anulohen pikat e sipërsënuara të urdhrin të Brendshëm nr.556, datë 25.11.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisciplinor/tumor bordeve”, për shkaqet e mëposhtme:

1. Siç edhe jeni në dijeni me anë të shkresave të dërguara më datë 05.03.2024, 30.04.2024, 29.05.2024 pranë QSUNT kemi kërkuar:
2. Kërkohet të merren masa të menjëhershme për të ndaluar shkeljet dhe veprimet e tjera të paligjshme, me pasoja dhe për shëndetin e pacientëve dhe të stafit, të shkaktuara nga përgjegjësi i njësies O.S në vendin e punës.
3. Përmbushja e kushteve të punës për kërkuesen, bazuar në kontratën e shërbimit me QSUNT duke marrë masa për pengesat e punës në ambientet e punës.
4. Kufizimin e aktivitetit klinik të mjekut O.S , në mungesë të specializimit dhe licencës së ushtrimit të profesionit si mjek onkolog, të lëshuar nga UMSH.

Si rezultat i kësaj situatë të krijuar në mënyrë të qëllimshme dhe me motivacionin e qartë nga ana e mjekut O.S , kërkuesja e ka të pamundur të ushtrojë detyrën, pasi:

- Nuk mund të marrë më pjesë në mbledhjet e stafit, për shkak të mënyrës krejt të papërshtatshme që mjeku i drejtohet asaj deri në kërcënim. Ai i drejtohet me shprehjen “Me ty do të merrem ndryshe”.
- Me vendosjen e letrave me kufizimet e orarit (që i ka vendosur vetë, pa miratimin e drejtorisë së QSUNT), ku nuk i lejon mjekët t’iu shërbejnë pacientëve sa herë ata kanë nevojë.
- Në një rast të tillë, ai e ka nxjerrë kërkuesen, Dr. F.K , forcërisht nga zyra, pse po punonte me fizikanët për një plan trajtimi të një pacienti (çështje që po ndiqet nga Prokuroria dhe Gjykata)
- Për mjekët dhe stafin, që ka kundërshtuar me argumente për sa sipër përdoren terma si “Llumi”, etj, ngjarje për të cilën, punonjësit kanë lëshuar deklaratat noteriale përkatëse.

Bazuar në Kodin e Punës, parashikohet detyrimi i punëdhënësit t'i krijojë punëmarrësve kushte normale për punë, pa pengesa, dhunë, diskriminim, duke kërkuar:

- Anulimin pjesërisht të aktit administrativ urdhër i brendshëm nr.556, datë 25.11.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisciplinor/tumor bordeve” duke e rishikuar këtë urdhër që të sigurohet mbrojtja nga diskriminimi dhe viktimizimi i Dr.F.K .
- Vendosjen në dispozicion të shkresës nga Shërbimi Onkologjik, mbi të cilin është propozuar organizimi i stafeve multidisciplinare.
- Njohjen me kriteret e vendosjes së mjekëve në stafet multidisciplinare duke marrë parasysh përgjegjësinë ligjore që paraqet vendimi i stafit multidisciplinar.

Së pari, vlen të theksohet se Dr.F.K , ushtron profesionin pranë Njesisë së Radioterapisë, për këtë arsye citimi radioterapeut nuk ka të bëjë me titullin si mjek onkolog, por Njësinë ku ushtron funksionin secili nga mjekët pjesë e urdhrit. Së dyti, sqarojmë se me shkresën nr.2938/2 prot, datë 11.12.2024 QSUNT i ka kthyer përgjigje ankueses duke e informuar se:

Drejtoria e Politikave të Shërbimit Spitalor pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSSHMS) nëpërmjet Urdhrit nr.402 datë 11.09.2024 me qëllim mirëfunksionimin dhe lehtësimin e rrugëtimit të qytetarëve në marrjen e shërbimit onkologjik sa më pranë vendbanimit, ka urdhëruar të gjitha drejtoritë e spitaleve që trajtojnë sëmundjet tumorale, të krijojnë dhe të bëjnë funksionale ekipet multidisciplinare/tumor bordet, të cilat do të funksionojnë sipas rregulloreve në shtojcën 1 të urdhrit.

Sipas shtojcës 1, të urdhrit me titull “Rregullore për ekipet multidisciplinare/tumor bordet”, pika 1, përcaktohet se: Ekipet multidisciplinare /tumor bordet kanë në lidhjen e tyre onkolog, kirurg, imazherist, radioterapeut, anatomopatolog, mjek specialist. Më tej pika 2 përcakton se trajtimi i pacientëve të diagnostikuar me sëmundjen e tumorit do të vlerësohet nga ekipi multidisciplinar/tumor bordet.

Më tej QSUNT bazuar në urdhrin nr.402, datë 11.09.2024 të MSHMS, ka vijuar me ngritjen e urdhrit “Për ngritjen e ekipeve multidisciplinare/tumor bordeve” dhe fillimin e aktivitetit të tyre.

Bazuar në nenin 133, pika 3, shkronja “c” të Kodit të Procedurave Administrative ku parashikohet se organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe interesave të tjerë publikë, QSUNT ka vlerësuar se zbatimi i këtij urdhri nuk mund të pezullohet, sepse është në interesi të lartë të shëndetit publik.

Për sa lidhet me ankesën e cituar “*Faza e tretë: 24 janar 2025 e në vijim*”, lidhur me faktin e bordeve të bashkëpunimit bazuar në Marrëveshjen që ka nënshkruar QSUNT me Sheba Medical

Center, ku ankuesja nuk është përfshirë në këto borde, sqarojmë se bordet nuk janë në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara të QSUNT me Sheba Medical Center apo të tjerë institucione spitalore me të cilët QSUNT ka bashkëpunim, pasi siç sqaruam këto borde janë ngritur në zbatim të politikave të MSSHMS për përmirësimin e shërbimit onkologjik. Sjellim në vëmendje se tagri i vendim marrjes për çështje administrative i takon Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT.

Për më tej, sjellim në vëmendje se në çdo strukturë shëndetësore, bashkëpunimi ndërmjet mjekëve është një nga shtyllat themelore për ofrimin e kujdesit cilësor, të sigurt dhe efikas ndaj pacientëve. Shërbimi mjekësor funksionon si një ekip i integruar ku çdo profesionist kontribuon me njohuritë, përvojën dhe përgjegjësinë e vet në interes të përbashkët shëndetin e pacientit. Komunikimi i hapur, ndarja e informacionit klinik, respekti i ndërsjellët dhe koordinimi i përbashkët janë thelbësorë për një atmosferë pune dhe për vendimmarrje të mirë informuar. Kur mjekët nuk bashkëpunojnë, krijohen keqkuptime, vonesa në trajtim, rritet mundësia për gabime mjekësore dhe në fund dëmtohet cilësia e shërbimit dhe mirëqenia e pacientit.

4. Pala ankuese ka depozituar nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor Av. G.R , prapësimet në lidhje me qëndrimin e depozituar nga QSUNT, të cilat u administruan pranë Komisionerit me nr.894/1 prot, datë 05.06.2025.
5. Më datë 05.06.2025 (administruar pranë Komisionerit me nr. 894 prot) pala ankuese ka paraqitur një kërkesë për shtimin e MSHMS, si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa. Ndër të tjera, pala ankuese parashtron se, megjithëse MSHMS është vënë në dijeni në mënyrë të vazhdueshme dhe me mjete zyrtare për problematikat që lidhen:
 - Vendosjen e personave pa kualifikim onkologjik në funksione vendimarrëse në Shërbimin Onkologjik;
 - Përjashtimin e padrejtë dhe selektiv të stafit të specializuar akademik nga bordet bashkëpunuese;
 - Mungesën e reagimit nga QSUNT ndaj një incidenti dhune në ambientet e punës;
 - Mospërputhjen e veprimeve administrative me ligjet në fuqi.

MSHMS nuk ka ndërmarrë asnjë akt verifikimi, hetimi apo korrigjimi, duke heshtur përballë shkeljeve serioze që cenojnë jo vetëm të drejtat profesionale dhe njerëzore të ankuses, por edhe cilësinë dhe sigurinë e trajtimit mjekësor të pacientëve onkologjikë. Kjo heshtje institucionale, përballë informimeve të përsëritura dhe të dokumentuara, bie ndesh me detyrimet ligjore të Ministrisë, si autoritet përgjegjës për mbikqyrjen e institucioneve publike shëndetore dhe universitare.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të ankeses nga ana e MSHMS dhe marrjen e masave të mëposhtme:

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses.
 - Ndërprenjen e diskriminimit në punë për ankuesen, duke u mundësuar kryerja e aktivitetit akademik dhe klinik, pa pengesa në shërbim, me pozitë të njëjtën juridike me mjekët e tjerë pedagogë;
 - Detyrimin e MSHMS të trajtojë në mënyrë efektive ankesat e paraqitura nga ankuesja dhe dhënia e informacioneve të nevojshme, të kërkuara rregullisht nga ankuesja.
 - Marrja e masave konkrete nga ana e MSSHMS për të ndaluar çdo lloj forme vendimarrje nga stafi jo onkologë i pranishëm në Shërbimin e Onkologjisë.
 - Marrja e masave konkrete nga ana e QSUNT për të ndaluar çdo lloj forme vendimarrje nga stafi jo onkologë i pranishëm në onkologjikë, për të siguruar zbatimin e misionit të QSUNT... *“ Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciare) për të gjithë territorin e vendit dhe shërbim mjekësor dytësor për Tiranën, të shërbejë me profesionalizëm duke respektuar rregullat e deontologjisë dhe të etikës mjekësore..”*
6. Me shkresën nr.577/4 prot datë 17.06.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga MSHMS, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
7. Nëpërmjet shkresës nr.2524/3 prot datë 03.07.2025, MSSHMS, informoi Komisionerin se i është drejtuar me një kërkesë për informacion QSUNT, pasi nuk disponojnë informacion lidhur me çështjen. MSHMS nuk depozitoi qëndrimin dhe parashtrimet e saj në lidhje me ankesën.
8. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 13.08.2025. Seanca dëgjimore e datës 13.08.2025, nuk u zhvillua, sepse QSUNT kërkoi shtyrjen e saj, pasi ishte në pamundësi për të marrë pjesë.

Për të garantuar të drejtën e palëve për tu dëgjuar dhe për të marrë pjesë në seancë dëgjimore, me shkresën nr. 577/8 prot., datë 01.09.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 10.09.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e ankueses znj. F.K dhe përfaqësuesit të saj Avokatit G.R dhe QSUNT-së, përfaqësuar nga znj. A.V, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, z. B.L, Drejtor i Drejtorisë Juridike, znj. F.S, Këshilltare e Jashtme e Drejtorit të Përgjithshëm, z.K. L, Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve Ligjore pranë Drejtorisë Juridike, znj. F.M, Përgjegjëse e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe z. L.H, Specialist pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, sipas autorizimit nr.431/6 prot datë 09.09.2025, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUNT.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të MSHMS, e cila edhe pse kishte rregullisht dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, nuk u paraqit dhe nuk paraqiti ndonjë justifikim të arsyeshëm për mospjesmarrjen.

9. Në vijim të seancës dëgjimore të datës 10.09.2025, pala ankuese depozitoi nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, Avokatit G.R , prapësimet dhe provat përkatëse në lidhje me pretendimet e QSUNT gjatë seancës dëgjimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ankuesja F.K që prej datës 13.12.2023, është e punësuar pranë QSUNT, si punonjës mjekësor i korpusit akademik i Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë/Mjek Pedagog në Shërbimin Onkologjik, fakt ky që rezulton i provuar sipas Kontratë Shërbimi – Mjek Pedagog, me nr.2266/3 prot datë 13.12.2023, të lidhur midis QSUNT dhe palës ankuese. Referuar vërtetimit me nr.7/3 prot datë 07.03.2025, të lëshuar nga QSUNT, rezulton se ankuesja ka punuar pranë QSUNT gjatë periudhës 01.09.2015 – 13.12.2023-13.12.2023 si mjeke onkologe, në Repartin e Rezatimit në Shërbimin Onkologjik, pra në të njëjtin vend ku vazhdon të jetë aktualisht e punësuar, por tashmë me statusin si Mjek Pedagog.

Ankuesja F.K , mban Gradën Shkencore Doktor dhe që prej datës 23.10.2023 është personel akademik me kontratë me afat të pacaktuar/pedagoge me kohë të plotë, në Departamentin e Kirurgjisë Lënda “Onkologji”, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë. Ky status si pedagoge me kohë të plotë, ka shërbyer edhe për punësimin e ankuseses si Mjeko Pedagoge, në Shërbimin Onkologjik, pranë QSUNT-së.

Në datën 04.03.2024, ankuesja ka paraqitur pranë QSUNT një ankesë, nëpërmjet të cilës kërkon marrjen e masave të menjëhershme për të ndaluar veprimet dhe sjelljet diskriminuese dhe sjellje të tjera të paligjshme nga Përgjegjësi i Njesisë RT O.S , në vendin e punës, bazuar në nenin 15, të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Ndër të tjera, ankuesja pretendon në këtë ankesë se, Përgjegjësi i Njesisë O.S , për shkak të sjelljeve diskriminuese ka krijuar një situatë të papranueshme në punë e cila e vendos ankuesen në kushte pamundësie për të marrë pjesë në mbledhjet e stafit, të kryejë aktivitetin klinik dhe të ofroj trajnimet për të cilat është kualifikuar.

Ankuesja pretendon se, në një mbledhje të zhvilluar më datë 19 janar 2024, ku ajo ka kundërshtuar kufizimet e orareve të caktuara nga Përgjegjësi i Njesisë, nëpërmjet letrave të vendosura në dyert

e ambienteve të punës, ky i fundit i është drejtuar me shprehjet “Me ty do të merrem ndryshe”, si dhe përdorimin e termave si “llumi”, për personat që e kundërshtojnë.

Ankuesja pretendon se diskriminohet në vendin e punës nga ana e Përgjegjësit të Njesisë O.S nëpërmjet, pengesave të vazhdueshme të kryerjes normale të punës, faktit që nuk mund të marrë më pjesë në mbledhjet e stafit, për shkak të mënyrës krejt të papërshtatshme, që ky person i drejtohet dhe kërcënimeve, më pusullat e letrave me kufizimet e orarit që përdoren si shkak për incidente, të cilat janë vendosur nga ana e tij dhe pa miratimin e askujt, duke mos lejuar që ti shërbehet pacientëve sa herë që ata kanë nevojë.

Ankuesja pretendon gjithashtu se, Përgjegjësi i Njesisë së Radioterapisë është një mjek imazherist i cili vulos me titullin “onkolog”, sipas ankueses duke kryer fallsifikim dhe duke e ekspozuar atë ndaj përgjegjësi si dhe ka krijuar vonesa në trajtimin e pacientëve me mënyrën e menaxhimit të punës dhe se një incident i tillë kishte ndodhur edhe në datën 04.03.2024, kur Shefi i Shërbimit kishte dhënë sipas ankueses urdhër verbal që të bllokohej fillimi i trajtimit të pacientëve të planifikuar me argumentin që aparaturat ishin të mbingarkuara, ndërkohë që deri në datë 27.02.2024 aparaturat e akselatorëve ishin ngarkuar me trajtimin e rreth 60 % të pacientëve që ishin në trajtim nga ana e tij, fakt i cili është i verifikueshëm nga shifrat e pacientëve në trajtim.

Në ankesën e datës 4.3.2024, ankuesja thekson se, incidentet dhe sjelljet arbitrare të përgjegjësit të njesisë janë të përsëritura dhe datojnë që prej vitit 2021, kur shefi i njesisë tentoi të miratonte një rregullore arbitrare në kundërshtim me rregulloren e QSUNT dhe në kundërshtim me legjislacionin për profesionet e rregulluara. Meqënëse kjo rregullore nuk u miratua, shefi i njesisë përdor metoda “de facto” duke vendosur kufizime se kur një mjek onkolog mund të punojë për trajtimin e pacientit, pavarësisht nga nevojat e tij dhe pa miratimin e Shefit të Shërbimit.

Ankuesja pretendon se, kufizimet e vendosura të cilat justifikohen nga përgjegjësi i njesisë me mbarëvajtjen e punës, në fakt krijojnë një skemë centralizimi pushteti arbitrar dhe korruptiv. Shkakut bazë i korrupsionit është vonesa, zvarritja, pra pacientët duhet patjetër të takojnë shefin e njesisë në mënyrë që të trajtohen dhe se shefi i shërbimit përpiqet të persekutojë dhe të largojë të gjithë ata që e kundërshtojnë.

Me emailin datë 05.03.2024, rezulton se ankuesja i është drejtuar Shefes së Shërbimit Onkologjik, në PAI Spitali Onkologjik znj. S.Ç dhe Drejtuesit Mjekësor në PAI Spitali Onkologjik z. H.N , duke vendosur për dijeni edhe Drejtoreshën e Përgjithshme të QSUNT, me pretendimin se ndihet e shqetësuar nga provokimet e qëllimshme dhe pengesat e vazhdueshme në punën e saj nga Shefi i Shërbimit O.S .

Bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, gjatë vitit 2021, një grup i mjekëve onkologë (katër mjekë, ku përfshihet edhe ankesja) në njësinë e radioterapisë, ka kundërshtuar mënyrën e organizimit të njesisë së radioterapisë së propozuar nga përgjegjësi i

njesisë O.S dhe ka kërkuar nga QSUNT verifikimin e profilit të specializimit dhe licensën e ushtrimit të profesionit të përgjegjës të njesisë.

Ankuesja pretendon se, më datë 10.8.2023 është nxjerrë forcërisht me dhunë nga zyra, nga ana e përgjegjës të njesisë O.S , pse po punonte me fizikantët për një plan trajtimi të një pacienti.

Nga aktet e administruara rezulton se më datë 10.10.2023, ankuesja ka informuar Drejtoreshën e Përgjithshme të QSUNT, Shufen e Shërbimit dhe Drejtuesin Mjekësor, se ka bërë kallëzim penal ndaj mjekut O.S , Përgjegjës i Njesisë së RT, për arsye se gjatë ushtrimit të detyrës së saj si mjeke në ambientet e punës, ai në mënyrë të përsëritur ka kryer veprime provokuese, intimiduese, presion psikologjik dhe thyerje të etikës profesionale, të cilat kanë cuar në datën 10.8.2023 edhe në kërcënim fizik. Ankuesja i deklaroi punëdhënësit nëpërmjet këtij *emaili* se ndihet e kërcënuar nga mjeku O.S dhe e frikësuar në ambientet e punës. Nga aktet e administruara nuk rezulton që nga ana e QSUNT në cilësinë e punëdhënësit të jetë ndërmarë asnjë masë për të verifikuar në lidhje me këto pretendime të ankueses.

Ankuesja pretendon se, në vijim të ankesës së datës 4.3.2025 është zhvilluar një mbledhje me Drejtoreshën e Përgjithshme të QSUNT znj. Albana F. për të sqaruar pretendimet e ngritura prej saj dhe për të ndaluar veprimet arbitrare ndaj ankueses, por për shkak të ndryshimit të largimit të znj. F. si titullare e QSUNT-së, nuk pati veprime të mëtejshme. Në lidhje me mbledhjen e pretenduar se është mbajtur në vijim të ankesës së datës 04.03.2024, nuk u administrua ndonjë procesverbal apo akt tjetër që të provojë këtë pretendim, ndërsa nga ana e QSUNT-së nuk u kundërshtua fakti që të jetë zhvilluar një mbledhje e tillë.

Në këto kushte, me ndryshimin e drejtimit në QSUNT, ankuesja i është drejtuar sërish me dy ankesa me shkrim respektivisht më datë 30.04.2024 dhe 29.05.2024.

Me ankesën e datës 30.04.2024 ankuesja rikërkon nga QSUNT, marrjen e masave të menjëhershme për të ndaluar veprimet dhe sjelljet diskriminuese dhe të tjera të paligjshme, me pasoja për jetën dhe shëndetin e pacientëve dhe të stafit të shkaktuara nga përgjegjësi i njesisë O.S , në vendin e punës, përmbushjen e kushteve të punës, bazuar në kontratën e shërbimit me QSUNT dhe kufizimin e aktivitetit klinik të mjekut O.S , në mungesë të specializimit dhe licencës së ushtrimit të profesionit si mjek onkolog, të lëshuar nga UMSH. Nëpërmjet kësaj kërke/ankese, ankuesja ka kërkuar nga QSUNT:

- Kryerjen e një kqyrje në shërbim, për të verifikuar nëse përgjegjësi i njesisë vulos me vullë ndryshe nga specialiteti i tij.
- Të verifikohet nëse janë të bazuara në ligj dhe në rregulloren e QSUNT dhe burim abuzimi deri në korrupsion oraret kufizuese të vëna në shërbim.
- Të verifikohet nëse janë krijuar pengesa fiktive për pacientët arbitrarisht nga mjeku O.S për tu vendosur në trajtim dhe është dashur ndërhyrje nga lart, që të lejohen mjekët specialist t'iu shërbejnë pacientëve?

- Të verifikohet nëse është e mundur që ankuesja të marrë pjesë në mledhje apo duhet të vijojë e izoluar se përgjegjësi e fyen sa herë e sheh, e fyen dhe i drejtohet në mënyrë arrogante.
- Të verifikohet, a mund të drjetojë një njësi si RT, një mjek pa specialitetin përkatës, pasi sipas ankueses, këtu e ka gjenezën gjithë sjellja e papërshtatshme e mjekut O.S ndaj saj, duke e konsideruar ankuesen si të vetmen pengesë për të vijuar aktivitetin e tij, i cili sipas ankueses të krijon të gjitha dyshimet e arsyeshme që është në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren e QSUNT.

Duke mos marrë një përgjigje për ankesën e datës 30.04.2024, ankuesja i është drejtuar sërish QSUNT me një kërkesë/ankesë më datë 29.05.2024, duke kërkuar informacion në lidhje me trajtimin e pretendimeve të paraqitura prej saj në ankesën e datës 30.04.2024. Po nëpërmjet kësaj kërkesë/ankese, ankuesja ka kërkuar edhe që ti vendoset në dispozicion disa dokumentacione që i përkasin përgjegjësit të njësisë O.S , si kontrata individuale e punës, licenca profesionale, ku shënohet specialiteti përkatës si dhe procedura e zhvilluar nga QSUNT për pozicion e përgjegjësit të njësisë së RT. Kjo kërkesë është administruar pranë QSUNT me nr.675/7 prot datë 31.05.2024.

Me shkresën nr.675/8 prot datë 13.06.2024, QSUNT i ka kthyer përgjigje ankueses lidhur me këtë kërkesë ankesë. Qëndrimi i QSUNT në këtë shkresë është i njëjtë me qëndrimin që QSUNT ka parashtruar para Komisionerit gjatë shqyrtimit të ankesës objekt shqyrtimi.

Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të paraqitura nga ankuesja, rezulton se QSUNT ka kërkuar informacion nga Shefja e Shërbimit Onkologjik znj. Silvana Celiku.

Konkretisht me shkresën nr. 675/5, datë 13.5.2024, Shefja e Shërbimit Onkologjik i drejtohet Drejtorisë së Burimeve Njerzore, duke parashtruar: *“Së pari dua të theksoj faktin që doktoreshë F.K , nuk më është drejtuar asnjëherë zyrtarisht për pretendimet që ajo ngre. Doktoresha këtë shqetësim të saj in ka preferuar ta ndajë me instanca të tjera jashtë Shërbimit Onkologjik. Së dyti sjell në vëmendjen tuaj që doktor O.S është emëruar përgjegjës i njësisë së radioterapisë, bazuar në vendimin nr.410, datë 12.6.2019, të titullarit të institucionit, duke ju referuar njëherazi procesverbalit të datës 24.5.2019 të Komisionit Ad Hoc ngritur me vendimin nr. 271, datë 23.5.2019. Ka qenë ky komision i ngritur për këtë qëllim, ka shqyrtuar, ka vlerësuar e më pas ka marrë vendimin që doktor O.S të emërohet përgjegjës i njësisë së radioterapisë. Së treti në lidhje me specializimin e doktor S., duke marrë si referencë “Licensën për ushtrimin individual të profesionit për mjekë”, lëshuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, doktori në fjalë ka specialitet Imazheri, Onkologji dhe Radioterapi, fakt ky që plotëson kriteret etiko profesionale për të ushtruar profesionin në profilin e tij. Theksoj se dosja personale e doktor O.S , administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzor, dhe sa më sipër kjo drejtori e disponon këtë informacion. Së katërti, duke ju referuar Rregullores së miratuar të QSUNT dhe konkretisht të drejtave dhe detyrimeve të pozicionit të përgjegjësit të njësisë.....në gjykimin tim si Shefe Shërbimi, doktor O.S ka vepruar në funksion të sa më sipër. Së pesti, duke ju referuar sa më sipër si dhe faktit që doktoreshë F.K , pavarësisht faktit që është pjesë e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, ajo është pjesë*

gjithashtu edhe e stafit mjekësor të Njesisë së Radioterapisë dhe si e tillë ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si dhe të gjithë mjekët e tjerë të kësaj Njësie. Së fundmi, përsa i përket problemeve personale të të dy mjekëve në fjalë, në vlerësimin tim ato duhet të zgjidhen jashtë Shërbimit Onkologjik, duke mos lejuar që kjo të ndikojë mbarëvajtjen e punëve në shërbim, duke theksuar këtu që çdo personel do të duhet të kryejë me përpikmëri detyrat e ngarkuara në varësi të pozicionit të punës.”

Me shkresën nr.835/3 prot datë 16.5.2024, Shefja e Shërbimit i drejtohet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, duke parashtruar: “ Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 835/2 prot datë 14.5.2024 me lëndë : “Përcjellje informacioni” në lidhje me problematikat e referuara në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore nga Dr.O.S , me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Radioterapisë dhe Dr.F.K pedagoge e Fakultetit të Mjekësisë dhe njëkohësisht mjeke radioterapeute pranë kësaj Njësie, si dhe duke ju referuar asaj që ju shprehni në shkresën tuaj, citoj “.....sa i përket detyrave funksionale të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, por në komunikim edhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Institucionit, ju bëjmë me dije se, referuar ankesave të znj.K. dhe z.S. që lidhen me çështje administrative të organizimit të brendshëm të Shërbimit Onkologjik në përgjithësi dhe Njesisë së Radioterapisë (Akselerator Rezatim Kobal) në vecanti janë deleguar dhe do të delegohen për vlerësim dhe trajtim pranë drejtuesve të PAI-t, si pjesë funksionale e tyre.....”, ju sqaroj se: Në gjykimin tim në cilësinë e Shefit të Shërbimit Onkologjik, ankesat e adresuara në Drejtori nga mjekët në fjalë nuk kanë të bëjnë me çështje administrative që i përkasin organizimit të brendshëm të Shërbimit Onkologjik. Sqaroj që Dr.O.S në cilësinë e Përgjegjësit të Njesisë, bazuar në Rregulloren e miratuar të QSUNT, detyrat e pozicionit që ai mbulon, kërkon nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si organi rregullator i marrëdhënieve të punës midis punonjësve dhe Institucionit, të bëhet me dije mbi të drejtat dhe detyrimet që Dr.F.K pedagoge e Fakultetit të Mjekësisë dhe njëkohësisht mjeke radioterapeute pranë Shërbimit Onkologjik, ka në lidhje me këtë të fundit (pozicioni i saj si mjeke radioterapeute në Shërbimin Onkologjik). Kjo kërkesë e tij vjen si rezultat i disa problematikave të hasura prej tij në menaxhimin e përditshëm të punëve në Njësinë e Radioterapisë, në lidhje me Dr.F.K . Ky fakt është shpjeguar prej tij në shkresën drejtuar Drejtorisë për këtë qëllim. Ndërkohë Dr.F.K , me apo pa arsye të shpjeguara nuk njeh Dr.O.S n si Përgjegjës i emëruar me procedurë i Njesisë së Radioterapisë, dhe për rrjedhojë anashkalon çdo urdhër apo organizim të tij në lidhje me mbarëvajtjen e punëve në këtë Njësi duke mos marrë pjesë edhe në asnjë prej mbledhjeve që Dr.S. organizon me stafin nën varësi.

Përsa i përket pozicionit tim si Shefe Shërbimi por njëkohësisht edhe pedagoge e brendshme në Fakultetin e Mjekësisë, duke cituar Rregulloren e miratuar të QSUNTdetyra ime përsa i përket pedagogëve të këtij Fakulteti të cilët ushtrojnë njëkohësisht edhe funksionet e tyre në shërbimin onkologjik, konsiston në mbikqyrjen e punës që bëhet me mjekët specializantë dhe studentët në Shërbimin Onkologjik, ndarjen e grupeve të tyre tek pedagogët përkatës, si dhe përcaktimin e orarit të mësimi. Në lidhje me funksionet e mia për sa i përket stafit mjekësor të Shërbimit Onkologjik, të cilët kanë lidhur marrëdhënien e punës me QSUNT, pozicioni im si Shefe Shërbimi ndër të tjera, konsiston në mbikqyrjen për zbatimin me përpikmëri të rregullores së

miratuar të QSUNT nga i gjithë personeli. Dua të sqaroj që përse i përket problematikave të krijuara së fundmi në Njësinë e Radioterapisë, vlerësoj që nga i gjithë stafi duhet të zbatohet rregullorja e miratuar e QSUNT, Kodi Etik si dhe duhet të respektohet e zbatohet me rigorozitet hierarkia e Shërbimit.....

Këto dy shkresa të Shefes së Shërbimit Onkologjik, nuk rezultojnë që ti jenë vendosur në dispozicion ankueses, e cila është njohur me to vetëm gjatë shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit.

Në datë 11.07.2024, ankuesja ka depozituar pranë QSUNT-së, kundërshtimet e saj në lidhje me shkresën nr.675/8 prot datë 13.06.2024, QSUNT, duke i konsideruar të pabazuar përgjigjen, duke pretenduar ndër të tjera se:

Ankuesja prapëson se, në asnjë nga urdhrat ku është bazuar procedura për përzgjedhjen e përgjegjësit të njësië së RT nuk parashikon zgjedhjen e përgjegjësve të njësisë por punësimin e mjekëve në strukturat spitalore, pra nuk ka një bazë ligjore për procedurën e rekrutimit të përgjegjësit të njësisë së RT.

Ankuesja pretendon se konfirmimi nga ana e QSUNT se mjeku O.S ushtron aktivitetin sipas licencës dhe specialitetit për “Imazheri, Onkologji dhe Radioterapi”, është ligjërisht dhe faktikisht i pamundur dhe e vendos institucionin e QSUNT para përgjegjësisë ligjore deri edhe atë penale. Sipas ankueses Universiteti i Mjekësisë nuk ka ofruar ndonjëherë program studimi në “Imazheri, Onkologji dhe Radioterapi”, pra në tre fusha së bashku dhe bazuar në legjislacionin Shqiptar mjekët kanë të drejtën e një specialiteti. Bazuar në publikimet zyrtare në faqen e Urdhrit të Mjekëve mjeku O.S ka kryer program studimi në “Imazheri”. Fakti që në dosjen personale të punës ndodhet një diplomë apo licencë e falsifikuar për specializim në “Imazheri, Onkologji dhe Radioterapi”, është një rrethanë e cila krijon dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e dy veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal në nenin 246 “Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore” ose në nenin 187 “Falsifikimi i dokumenteve shkollore”, kjo pasi specializimi është program studimi i ciklit të tretë.

Ankuesja pretendon se QSUNT nuk ka kryer asnjë verifikim në lidhje me shqetësimin e ushtruar ndaj saj nga ana e përgjegjësit të njësisë në vendin e punës, dhunën verbale, psikologjike, përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj saj, dhe se pavarësisht ndjekjes penale, QSUNT ka patur detyrimin që të hetojë rrethanat administrative në lidhje me dhunën fizike të ushtruar ndaj ankuese në lidhje me incidentin e ndodhur më datë 10.8.2023, ku ankuesja pretendon se në vendin e punës është ushtruar dhunë fizike ndaj saj nga ana e përgjegjësit të njësisë. Ankuesja prapëson se, në bazë të Rregullores së QSUNT, si mjeke pedagoge, ajo nuk ka varësi nga përgjegjësi i njësisë por nga shefi i shërbimit onkologjik.

Nëpërmjet emailit të datës 23.07.2024, drejtuar Shefes së Shërbimit Onkologjik znj. S.Ç dhe Drejtuesit Mjekësor z. H.N , për dijeni znj. A.S , Zv/Dr. e Përgjithshme e QSUNT-së, parashtrohet një relacion të sajin lidhur me mbledhjen e mbajtur më datë 11.07.2024. Referuar përmbajtjes së

emailit, ankuesja parashtron një sërë problematika që lidhen me trajtimin e pacientëve në njësinë e radioterapisë, të cilat sipas saj shkaktohen në mënyrë të qëllimshme nga përgjegjësi i njësisë, dhe se dhuna fizike dhe psikologjike në vendin e punës nuk mund të konsiderohet mosmarrëveshje personale.

Nëpërmjet *emailit* të datës 16 gusht 2024, ankuesja i është drejtuar me *email* Drejtuesit Mjekësor dhe Shefit të Shërbimit në Spitalin Onkologjik, në lidhje me rregulloren dhe procedurën standarde të rishikuar për vizitat e pacientëve. Ankuesja pretendon se mënyra e organizimit të vizitave të para në njësinë RT, e hartuar nga përgjegjësi i njësisë vjen në kundërshtim me udhëzimin dhe mënyrën e organizimit të vizitave në të gjithë shërbimet në QSUNT. Ankuesja pretendon se koha e vizitave nuk mund të ndahet me 1/3 me grupe, dhoma e vizitave nuk mund të organizohet me 2 poste, pra 2 mjekë të kryejnë vizita në të njëjtën kohë në të njëjtin ambient dhe se, ankuesja si staf akademik, kërkon që ditët e saj të vizitave të jenë të plota për të mundësuar planifikimin e angazhimeve të tjera klinike dhe akademike. Ankuesja nga Drejtuesi Mjekësor dhe Shefi i Shërbimit Onkologjik, rishikimin e ndarjes së vizitave meqënëse ndarja e vizitave është në përgjegjësinë dhe kërkon aprovimin e tyre.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr.556, datë 25.11.2024 “Për Ngritjen dhe Funkcionimin e Ekipeve Multidisiplinor/Tumor Bordeve”, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, ankuesja është përcaktuar në tre bordet multidisiplinare të mëposhte:

1.Bordi multidisiplinor për Shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme e Digjестive Nr.3, me përbërjen si më poshtë:

- Prof A. Gj	Shefi i Shërbimit
- Znj. A.H/Znj.Q A	Mjekë imazherist
- D.SH.M E. C/Z.B. K	Mjekë onkolog
- <u>Z. O.S /Znj.B.Sh /D.Sh.M F.K</u>	<u>Mjekë radioterapeut</u>
- Znj. E. C	Mjekë anatomopatolog

2.Bordi Multidisiplinar për Shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme Nr.1 me përbërjen si më poshtë:

- Prof.Asc.M. K	Mjek kirurg
- Znj.E.T	Mjek imazherist
- D.SH.M E. C/Znj.S. A	Mjekë onkolog
- <u>D.SH.M F.K /Znj.B.Sh</u>	<u>Mjekë radioterapeut</u>
- Znj. E. C	Mjek anatomopatolog

3.Bordi multidisiplinar për Shërbimin e Urologjisë, me përbërjen si më poshtë:

- D.SH.M R.Xh	Shefi i Shërbimit
- Znj.D.N/Znj.E.M	Mjeke imazherist

- Z.R.B/Z.S. S/Z. B. K	Mjekë onkolog
- <u>Z.O.S /D.SH.M F.K /Znj.B.J</u>	Mjekë radioterapeut
- Znj.I. Rr	Mjek anatomopatolog

Sipas urdhrit të sipërcituar, përvec bordeve të mësipërme krijohen edhe pesë borde të tjera multidisciplinare, konkretisht për Shërbimin e Neurologjisë/Neurokirurgjisë; Shërbimin Maksilofacial,Otorinolaringologji; Shërbimin e Onko-Pediatrisë; Shërbimin e Onkologjinekologji dhe bordin multidisciplinor onko-kirurgji për patologji malinje të gjirit, melanoma, sarcoma, ku ankuesja nuk është e përfshirë. Mjeku O.S , përvec bordeve të mësipërme ku është së bashku me ankuesen është përfshirë edhe në katër borde të tjera, ndërsa nuk është përfshirë vetëm në atë të Shërbimit Onkologjinekologji. Pra në total ankuesja është përfshirë në tre borde multidisciplinare, ndërsa mjeku O.S është përfshirë në shtatë borde multidisciplinare.

Ankuesja i është drejtuar QSUNT më datë 4.12.2025 me një ankim për anulimin e menjëhershëm dhe pjesërisht të aktit administrativ “Urdhër i Brendshëm” nr.556 datë 25.11.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisciplinor/tumor bordeve”.

Në ankimin e saj ankuesja pretendon se, për shkak të problematikave të vazhdueshme dhe pengesve të krijuara nga përgjegjësi i njësisë O.S , kërcënimeve dhe sjelljeve jo etike nga ana e tij, për të cilat ankuesja ka paraqitur ankesat e saj pranë QSUNT dhe për të cilat QSUNT nuk ka marrë masa për trajtimin e tyre, ajo ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit për të qënë pjesë në të njëjtin grup pune së bashku me O.S n. Për shkak të konflikteve me mjeken B.Sh , ankuesja pretendon se edhe në këtë rast nuk duhet të jetë në një grup të përbashkët pune.

Sipas ankueses, lëshimi i këtij urdhri të brendshëm për mënyrën e krijimit të ekipeve multidisciplinor/tumor bordeve, në këto kushte, kërkon t’a ekspozojë atë ndaj situatave konfliktuale, për të cilat QSUNT ka dijeni. Sipas ankueses, urdhri i brendshëm duhet të rishikohet edhe sa i takon emërtimeve që nuk ekzistojnë në diplomën e saj. Ankuesja parashtron se ajo është Onkologe, është punësuar si onkologe dhe si staf akademik onkologe, termi Radioterapeute është term që nuk përmbahet në diplomën dhe specialitetin e saj. Ky titull nuk ekziston dhe nuk përfaqëson stafin e onkologëve. Ndërsa kërkon të verifikohet edhe fakti që të njëjtët mjekë A.A dhe A.M, mjekë onkologë, deklarohen dhe si onkologë dhe si radioterapeut, gjë që nuk është e mundur. Ankuesja kërkon t’i vendoset në dispozicion informacioni në lidhje me faktin se cilët kanë qënë personat që kanë propozuar vendsojen e saj në të njëjtat borde me përgjegjësin e njësisë.

Pala ankuese ka paraqitur pranë QSUNT edhe një kërkesë nëpërmjet të cilës kërkon pezullimin e zbatimit të aktit administrativ “Urdhër i brendshëm” nr.556, datë 25.11.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisciplinor/tumor bordeve”, për ankuesen deri në shqyrtimin e ankimit të datës 4.12.2024. Ankuesja pretendon se, mospezullimi i aktit administrativ dhe zbatimi i tij pa u trajtuar ankesa e datës 4.12.2024, do ta vendoste ankuesen në pozita diskriminuese.

Me shkresën nr.2938/2 prot datë 11.12.2024, QSUNT ka refuzar kërkimin e ankueses për të pezulluar zbatimin e aktit administrativ urdhrit të brendshëm nr.556 datë 25.11.2024, bazuar në parashikimet e nenit 133, pika 3, gërma “c”, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet : “ 3. Zbatimi i aktit administrativ ndaj aktit nuk pezullohet kur:c) organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe të interesave të tjerë publik.”

QSUNT argumenton se, urdhri i brendshëm për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinore/tumor bordeve është nxjerë në bazë dhe për zbatim të urdhrit nr.402 datë 11.9.2024 të MSHMS, në kuadër të politikave të shërbimit spitalor dhe me qëllim mirëfunksionimin dhe lehtësimin e rrugëtimit të qytetarëve në marrjen e shërbimit onkologjik sa më pranë vendbanimit. Për këtë arsye zbatimi i këtij urdhëri është në interes të lartë të shëndetit publik.

Nga aktet e administruara rezulton se në datë 1.11.2024, është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi midis QSUNT dhe Fondit Sheba për Kërkime Mjekësore (The Sheba Fund for Medical Research), i cili për shkak të dispozitave të konfidencialitetit të parashikuara në përmbajtjen e tij, nuk do të elaborohet më shumë nga ana e Komisionerit.

Ankuesja pretendon se, në kuadër të kësaj marrëveshje kanë filluar bordet e bashkëpunimit, por ajo që është pedagogje e onkologjisë dhe mjeke me këtë specialitet në shërbim nuk është përfshirë, duke përfshirë në mënyrë arbitrare mjekë-jopedagogë të specialitetit të “onkologjisë”. Pra, në bordet e bashkëpunimit janë përfshirë të gjithë mjekët pedagogë të shërbimit të onkologjisë dhe vetëm ankuesja është lënë jashtë. Ankuesja parashtron se, vendimarrjet e këtyre bordeve janë të rëndësishme për vijimin e punës në shërbimin e onkologjisë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, QSUNT prapësoi këtë pretendim të ankueses duke parashtruar se në kuadër të Memorandimit të Mirëkuptimit me Sheba Medical Center, nuk janë krijuar borde bashkëpunimi. Borde janë ngritur në zbatim të politikave të MSHMS për përmirësimin e shërbimit onkologjik.

Ankuesja ka parqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi në të cilën pretendon se është diskriminuar në vendin e punës për shkak të gjendjes arsimore dhe në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, nga ana e QSUNT dhe MSHMS.

- ***Në lidhje me pretendimet e ankueses për diskriminim nga ana e QSUNT.***

Statusi i e ankueses në raport me QSUNT

Ankuesja pretendon se është diskriminuar në të drejtën e saj për punësim. Në këto kushte, në radhë të parë Komisioneri, do të ndalet për të sqaruar natyrën e marrëdhënies juridike midis ankueses dhe QSUNT.

Referuar Kontratës së Shërbimit të lidhur midis palëve në vitin 2023, nuk rezulton që të jenë cituar dispozita të Kodit të Punës, si bazë ligjore që rregullon marrëdhënien e vendosur midis palëve ankeuses dhe QSUNT. Në kontratën e lidhur midis ankueses dhe QSUNT përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë se, legjislacioni i posaçëm në fushën e arsimit të lartë, aktet normuese të Universitetit të Mjekësisë, aktet që rregullojnë veprimtarinë e QSUNT-së, si Rregullorja Bazë e Funksionimit të QSUNT, Kodi Etik për Punonjësit e QSUNT. Kontrata e lidhur mes palëve, edhe pse emërtohet kontratë shërbimi nuk përmban dispozita të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e shërbimit ndërsa nuk ka të vendosur si bazë ligjore Kodin e Punës.

Referuar Rregullores bazë të Funksionimit të QSUNT, rezulton se pozicioni Mjek i Shërbimit Mjekësor Universitar, duke përfshirë pozicionin e mjekut pedagog si në rastin e ankueses, është pjesë e strukturës së QSUNT. Gjithashtu në bazë të Kontratës së Shërbimit të nënshkruar në vitin 2023, që rregullon marrëdhënien midis palëve, se ankuesja është subjekt i Kodit të Etikës së Punonjësve të QSUNT.

Bazuar në nenin 12, të Kodit të Punës, të ndryshuar, parashikohet : *“Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.”*

Sikundër përcaktohet në nenin 12, të K.Punës, kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, natyra e vërtetë e marrëdhënieve mes palëve, përcaktohet bazuar në dispozitat e Kodit të Punës. Sa më sipër, për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie punësimi, duhet të vlerësohen aspektet e mëposhtme:

- Punëmarrësi e ofron punën ose shërbimin në kuadër të organizimit dhe urdhrave të punëdhënësit. Kjo do të thotë se punëdhënësi është ai që ka kontrollin e punës. Kjo nënkupton që punëmarrësi është në varësinë e punëdhënësit, përsa i përket orarit dhe disiplinës në punë.
- Puna ose shërbimi kryhet për përfitim të punëdhënësit dhe se puna apo shërbimi detyrimisht duhet të kryhet personalisht nga punëmarrësi. Detyrimi i kryerjes së punës personalisht nga punëmarrësi parashikohet në mënyrë specifike nga neni 22, i Kodit të Punës³.

³ Neni 22, i Kodit të Punës: *“1. Punëmarrësi kryen personalisht punën e ngarkuar, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje parashikohet e kundërta. 2. Nuk është i vlefshëm zotimi i punëmarrësit për t'i siguruar punëdhënësit një zëvendësues, kur ai nuk është i detyruar të punojë si pasojë e zbatimit të këtij Kodi.”*

- Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se puna ose shërbimi ofrohen kundrejt një shpërblimi. Shpërblimi për punën ose shërbimin është një pagesë periodike. Periodiciteti i pagës parashikohet nga neni 116, i Kodit të Punës ku përcaktohet se, *punëdhënësi i paguan rregullisht pagën punëmarrësit çdo dy javë, kur paga llogaritet me orë, ditë ose javë dhe në fund të çdo muaji kur llogaritet me muaj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshje me shkrim*. Shpërblimi për punën ose shërbimin, është një pagesë që nuk kërkohet përmes faturave ose në përfundim të një kontrate për ofrimin e shërbime të përcaktuara.
- Vendosja e një marrëdhënie punësimi midis palëve sjell njohjen e të drejtave të tilla si pushimi javor apo pushimi vjetor, pushimi në ditët e festave zyrtare, sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

Nga zbatimi i aspekteve të mësipërme në çështjen objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se, marrëdhënia juridike midis ankueses F.K dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, pavarësisht se emërtimi formal i kontratës së nënshkruar nga palët është kontratë shërbimi. Ky përfundim i arritur nga Komisioneri, bazohet në arsyetimin e mëposhtëm:

Puna ose shërbimi i ofruar nga ankuesja për QSUNT ofrohet në kuadër të organizimit dhe urdhrave të QSUNT-së. Pra, është QSUNT që ka kontrollin e punës. Kjo nënkupton që ankuesja është në varësinë e QSUNT, për sa i përket orarit dhe disiplinës në punë. Aspekte të respektimit të disiplinës dhe etikës në punë parashikohen në kuadër të nenit 5 të kontratës që palët kanë nënshkruar pavarësisht se emërtimi i kësaj dispozite është “Detyrimet e ofruesit të shërbimit” duke shmangur përdorimin e termit punëmarrës. Puna ose shërbimi i ofruar nga ankuesja bëhet për përfitim të QSUNT dhe ankuesja e ofron shërbimin ose kryen punën që i ngarkohet, personalisht.

Një nga aspektet me rëndësi në përcaktimin e faktit nëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune, është shpërblimi për punën ose shërbimin. Në rastin objekt shqyrtimi, shpërblimi i bëhet në mënyrë periodike, kundrejt listëprezencave të mbajtura nga QSUNT dhe ky shpërblim nuk është i kërkueshëm nga ankuesja përmes faturave ose në përfundim të kontratës për punën e kryer ose shërbimin e ofruar.

Referuar kontratës së nënshkruar nga palët, ankuesit i njihen të drejta të tilla si pushimi javor, dhe vjetor i paguar si dhe pushimi në ditët e festave zyrtare.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se natyra juridike e marrëdhënies së krijuar midis ankueses F.K dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, dhe për rrjedhojë, pretendimi i ankueses se është diskriminuar do të trajtohet në kuadër të pretendimeve për diskriminim në fushën e punësimit⁴.

⁴ Shiko: Vendim nr. 108, datë 14.06.2021, të Komisionerit.

- Në lidhje me pretendimet për diskriminim të ankueses të emërtuara *“Faza e parë: Periudha 2021 e vijim”*.

Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankueses në lidhje me paligjshmërinë në ushtrimin e profesionit të onkologut pa specializimin përkatës nga mjeku O.S , përgjegjës i njësisë së radioterapisë, procedurën për punësimin e këtij të fundit në pozicionin e përgjegjës të njësisë së radioterapisë, si dhe të gjitha pretendimet e tjera të ngritura nga ankuesja në lidhje me cilësinë, sigurinë apo çështje të tjera që kanë të bëjnë me organizimin ose funksionimin e shërbimit shëndetësor në shërbimin onkologjik, janë pretendime që dalin nga objekti i çështjes, përfshijnë persona të tretë dhe nuk hyjnë në kompetencën e Komisionerit.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se që prej vitit 2021 ankuesja në mënyrë të vazhdueshme ka paraqitur ankesa ndaj përgjegjës të njësisë së radioterapisë. Rezultoi e provuar se këto ankesa i janë bërë me dije Shefes së Shërbimit Onkologjik, Drejtuesit Mjekësor të Spitalit Onkologjik, drejtuesve të QSUNT. Ankuesja pretendon se si pasojë e këtyre ankesave është ekspozuar ndaj sjelljeve diskriminuese në vendin e punës nga ana e përgjegjës të njësisë së radioterapisë O.S , të tilla si:

- Ankuesja nuk mund të marrë më pjesë në mbledhjen e stafit, për shkak të mënyrës krejt të papërshtatshme, që përgjegjësi i njësisë i drejtohet;
- Me pusullat e letrave me kufizimet e orarit, të vendosura nga ana e përgjegjës të njësisë, pa miratimin e drejtueses së shërbimit apo të QSUNT dhe të pambështetura në rregulloren e QSUNT apo PAI Onkologjik, krijohen pengesa që nuk lejon t’iu shërbejnë pacientëve sa herë ata kanë nevojë. Në një rast të tillë, më datë 10.8.2023, ankuesja është nxjerrë forcërisht me dhunë nga zyra, pse po punonte me fizikantët për një plan trajtimi të një pacienti, çështje që po ndiqet penalisht nga Prokuroria;
- Mjeku O.S që është theksht një mjek me specialitetin “imazherist”, vijon vulos me titullin “Onkolog” dhe kjo është një paligjshmëri e rëndë, mbi kartelat e pacientëve.
- Për mjekët dhe stafin, që e kanë kundërshtuar me argumente për sa sipër përdor termat “llumi” etj, ngjarje për të cilën, punonjësit kanë lëshuar deklaratat noteriale përkatëse.

Në ankesën pranë Komisionerit, ankuesja pretendon se sjelljet diskriminuese në vendin e punës janë kryer nga një punonjës i punëdhënësit/QSUNT, në rastin konkret nga përgjegjësi i njësisë RT O.S , i cili nuk është palë e këtij shqyrtimi administrativ, ndërsa pretendon përgjegjësinë ndaj punëdhënësit/QSUNT për shkak se nuk ka marrë masa për mbrojtjen e saj nga sjelljet diskriminuese në vendin e punës duke mos trajtuar në mënyrë efektive ankesën e saj për diskriminim.

Rezultoi e provuar se ankuesja në datën 4.3.2024 ka paraqitur pranë punëdhënësit/QSUNT një ankesë për diskriminim në vendin e punës, duke pretenduar se diskriminohet nga ana e përgjegjësit të njësisë së radioterapisë Orges Shehu, sipas parashikimeve të nenin 15 të LMD.

Neni 15, i LMD, parashikon : “1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës. 3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit. 4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë.”

Në nenin 13, të LMD, parashikohet : “1. Punëdhënësi është i detyruar: a) të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi; b) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dijenisë; c) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre. 2. Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara.”

LMD në nenin 3, pikat 1, , parashikon se: “1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”, ndërsa parashikon po në këtë dispozitë, disa forma nëëprmet të cilave mund të shfaqet diskriminimi, koncretisht: “.8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.....13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë..... 17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose

pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.....”

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesja ka marrë përgjigje nga punëdhënësi/QSUNT në lidhje me ankesën e saj për diskriminim me shkresën nr. 675/8 prot datë 13.6.2025 të QSUNT, pasi ka ripërsëritur ankesën e saj më datë 30.04.2024 dhe 29.05.2024, rreth 3 muaj e gjysëm pas paraqitjes së ankesës.

Bazuar në aktet e administruara, Komisioneri konstaton se, nga ana e punëdhënësit/QSUNT, nuk është kryer asnjë hetim administrativ në lidhje me pretendimet për diskriminim të paraqitura nga ankuesja, me pretendimin se, në referim të nenit 82, të Kodit të Procedurave Administrative, barra e provës për të provuar diskriminimin e pretenduar i takon ankueses.

Neni 82, i Kodit të Procedurave Administrative parashikon në pikat 1 dhe 2 të tij, se: *“1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*

Neni 82, i Kodit të Procedurave Administrative, ka parashikuar një standard të ndryshëm prove në lidhje me çështjet e diskriminimit, i ndryshëm nga parrimi i përgjithëm se kush pretendon, provon. Përpos, kësaj, bazuar në nenin 77, të Kodit të Procedurave Administrative, organi publik ka detyrimin të hetojë kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

Parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative janë në harmoni me parashikimet e legjislacionit të posacëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në rastin konkret LMD. Në nenin 33, pika 7/1, të LMD, përcaktohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*. Ky parashikim, pavarësisht se, rregullon procedurën e shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit përbën standardin ligjor të barrës së provës në çështjet e diskriminimit, përfshi diskriminimin në fushën e punësimit.

I njëjti standard prove në lidhje me çështjet e diskriminimit, parashikohet edhe për shqyrtimin e padive për diskriminim përpara gjykatës. Konkretisht në nenin 36, pika 6, të LMD sanksionohet se: *“6. Pasi paditësi paraqet fakte, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave*

gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.”

Kodi i Punës, i cili gjen zbatim edhe në rastin konkret, pasi ankuesja dhe QSUNT janë në pozitë punëmarrëse dhe punëdhënëse, parashikon në nenin 9, pika 10, se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”*

Në kuadër të LMD, punëdhënësi ka detyrime të posacme për mbrojtur punëmarrësin nga diskriminimi në vendin e punës dhe të trajtojë në mënyrë efektive ankesat për diskriminim që i paraqiten nga ana e tyre. Punëdhënësi/QSUNT ka zbatuar në mënyrë të gabuar barrën e provës në lidhje me trajtimin e ankesës për diskriminim të paraqitur nga ankuesja dhe nuk ka realizuar një hetim efektiv të ankesës. Komisioneri vlerëson se në rastin konkret, përgjigja formale që ankueses i është kthyer me shkresën nr. 675/8 prot datë 13.6.2024, nuk mund të konsiderohet një trajtim efektiv i ankesës për diskriminim që ankuesja ka paraqitur pranë punëdhënësit/QSUNT.

Duke ju referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes, të cilat u provuan gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, QSUNT në cilësinë e punëdhënësit, nuk arriti të provojë se ka trajtuar dhe hetuar në mënyrë efektive ankesën e paraqitur nga ankuesja në datë 4.3.2024, në të cilën pretendon se po diskriminohet në vendin e punës nga ana e përgjegjësit të njësisë së radioterapisë, për shkak të ankesave që ka paraqitur kundër tij dhe kundërshtimit e mosnënshtimit ndaj urdhrave të pretenduar si të padrejtë.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se punëdhënësi QSUNT nuk i është përgjigjur në mënyrë efektive ankimit për diskriminim në vendin e punës të paraqitur nga ankuesja.

Bazuar në nenin 2, të LMD, një nga qëllimet këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Komisioneri vlerëson se, me sjelljen e saj QSUNT në cilësinë e punëdhënësit, ka cenuar të drejtën e ankueses për një mbrojtje efektive nga diskriminimi, pasi ankesa dhe pretendimet e saj për diskriminim në vendin e punës nuk janë trajtuar në mënyrë efektive nga ana e saj.

Komisioneri vlerëson se sjellja e QSUNT vjen në kundërshtim me qëllimin e LMD dhe me ndalimin e diskriminimit sipas përcaktimit të nenit 5, pika 1, të po këtij ligji.

Komisioneri vlerëson se, ankuesja F.K i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e QSUNT në cilësinë e punëdhënësit, pasi nëpërmjet mostrajtimit në mënyrë efektive të ankesës për diskriminim në vendin e punës që ankuesja ka paraqitur pranë QSUNT në cilësinë e punëdhënësit, i është cënuar e drejta për të patur një zgjidhje dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi në vendin e punës. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se, QSUNT e ka diskriminuar ankuesen dhe për rrjedhojë QSUNT ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

- Në lidhje me pretendimet për diskriminim të ankueses të emërtuara “Faza e dytë : 25 nëntor 2024 e vijim”.

Ankuesja pretendon se urdhri i brendshëm nr.556, datë 25.11.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinore/tumor-bordeve”, i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, i cili vijon të jetë në fuqi krijon diskriminim në punë për ankuesen.

Referuar pretendimeve të ankueses, në lidhje me këtë pikë, Komisioneri vlerëson se, pretendimet në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me aspekte teknike ose klinike të ushtrimit të profesionit të mjekut, janë pretendime që dalin nga objekti i çështjes, përfshijnë persona të tretë dhe ato nuk hyjnë në kompetencën e Komisionerit.

Referuar shkresës nr.2938/2 prot datë 11.12.2024, rezulton se, QSUNT nuk ka pranuar kërkesën e ankueses për të pezulluar zbatimin e aktit administrativ me arsyetimin se zbatimi i këtij urdhëri është në interes të lartë të shëndetit publik.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton që QSUNT nuk ka marrë në shqyrtim, nuk ka vlerësuar dhe trajtuar ankimin dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja në ankimin e saj të datës 4.12.2024, kundër aktit administrativ, urdhrit të brendshëm nr.556, datë 25.11.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, nëpërmjet të cilit kërkon që të mos caktohet në grupe të përbashkëta pune me mjekun O.S për shkak të situatës konfliktuale dhe pretendimeve për diskriminim që ka ngritur kundër tij, si dhe mjekes tjetër B.Sh .

Nuk rezulton që QSUNT të ketë shqyrtuar në një moment të dytë pas shkresës nr.2938/2 prot datë 11.12.2024 ankimin e paraqitur nga ankuesja, ndërsa nuk u parashtrua para Komisionerit asnjë shkak për mosmarrjen në trajtim të këtij ankimi.

QSUNT gjatë shqyrtimit të ankesës nuk paraqiti anjë shpjegim në lidhje me pretendimin e ankueses se ajo nuk duhet të ishte vendosur në të njëjtin grup pune me mjekun O.S , dhe mjeken tjetër B.Sh .

QSUNT parashtroi se, pretendimet e paraqitura prej ankueses në ankimin e saj, lidhen me problematikat dhe pengesat e krijuara mes saj dhe mjekut O.S .

Komisioneri konstaton se fakti që QSUNT nuk ka trajtuar në mënyrë efektive dhe shteruese ankesat e paraqitura nga ankuesja, bën që problematikat jo vetëm të mos gjejnë zgjidhje por edhe për faktin se situata konfliktuale vijon prej një kohe të gjatë, problematikat thellohen.

Në mënyrë të pajustificuar pretendimet dhe problematikat e parashtruara nga ankuesja në ankesat e saj konsiderohen probleme personale midis saj dhe mjekut O.S . Nga përmbajtja e ankesave apo e komunikimeve të ndryshme, midis ankuses dhe drejtuesve të shërbimit dhe drejtuesve të QSUNT, shqetësimet dhe problematikat që ankuesja adreson, krahas pretendimeve për diskriminim në vendin e punës, konsistojnë një sërë problematikash që lidhen me mbarëvajtjen e punës dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit shëndetësor ndaj pacientëve.

Edhe pse ka marrë dijeni që në momentin e parë, QSUNT nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë për të verifikuar pretendimin e ankuses për përdorim të dhunës fizike në vendin e punës nga ana e përgjegjësit të njësisë O.S , të ndodhur në datë 10.8.2023. Kallëzimi penal që ankuesja ka bërë ndaj mjekut O.S , nuk paraqet pengesë për QSUNT në cilësinë e punëdhënësit, që të verifikojë në kuadër të marrëdhënieve të punës nëse kemi shkelje të rregullave në punë.

Komisioneri konstaton se fakti që QSUNT nuk ka trajtuar në mënyrë efektive dhe shteruese ankesat e paraqitura nga ankuesja, bën që problematikat jo vetëm të mos gjejnë zgjidhje, por edhe se situata konfliktuale vijon prej një kohe të gjatë, problematikat thellohen.

Në lidhje me pretendimin e ankuses se i vendoset emëritimi mjeke radioterapeute, një titull që jo vetëm nuk e ka pasi është onkologe por edhe pse sipas ankuses një emërtim/titull i tillë nuk ekziston.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, QSUNT parashtroi se, ankuesja ushtron profesionin pranë Njësisë së Radioterapisë, për këtë arsye citimi Radioterapeut, nuk ka të bëjë me titullin si mjek onkolog, por Njësinë ku ushtron funksionin secili nga mjekët pjesë e urdhrit.

Referuar urdhrit të brendshëm, konstatohet se termi mjek radioterapeut nuk përdoret vetëm për ankuesen por edhe për mjekë të tjerë. Pra, edhe nëse ky term/emërtim nuk është i saktë dhe si i tillë nuk duhet të përdoret, në kushtet kur përdorimi i këtij termi nuk aplikohet vetëm ndaj ankuses, nuk kemi të bëjmë me diferencë në trajtim.

- Në lidhje me pretendimet për diskriminim të ankuses të emërtuara “Faza e tretë: 24 janar 2025 e vijim”

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk rezultoi i provuar pretendimi i ankuses, se në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimi midis QSUNT dhe Fondit Sheba për Kërkime Mjekësore (The Sheba Fund for Medical Research), të jenë krijuar borde bashkëpunimi, nga të cilat ankuesja të jetë përjashtuar duke mos u bërë pjesë e tyre.

- Në lidhje me pretendimet e ankuses për diskriminim nga ana e MSHMS.

Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankueses për diskriminim nga ana e MSHMS nuk janë të bazuara pasi MSHMS nuk ka statusin e punëdhënësit.

QSUNT, është një institucion shëndetësor publik që ofron kujdes shëndetësor terciar. QSUNT, është një qendër spitalore universitare, e cila bazuar në nenin 13, pika 7, të ligjit 55/2022 “*Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*”, realizon funksione diagnostikuese e trajtuese, në mbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si dhe funksione mësimore e kërkimore, shkencore, për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si edhe për studentët/praktikantët, të cilët zhvillojnë studimet pranë institucioneve të arsimit të lartë për të kryer praktikat mësimore dhe kërkimore-shkencore. Bazuar në nenin 5, të ligjit 55/2022 “*Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*”, MSHMS, ka ndër të tjera kompetencën që të organizojë, monitorojë dhe auditojë veprimtarinë e spitaleve publike sipas legjislacionit në fuqi, përfshi këtu edhe QSUNT.

Bazuar në nenin 4, të ligjit Nr.10 107, datë 30.3.2009 “*Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, MSHMS, drejton politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor.

Duke mbajtur në konsideratë, që çështjet dhe problematikat që ankuesja parashtroi kanë të bëjnë me aspekte të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe veprimtarinë spitalore në QSUNT si dhe faktin që problematikat e pretenduara janë serioze (Komisioneri nuk mund të vlerësojë bazueshmërinë e pretendimeve të ankueses), pasi ankuesja pretendon për ushtrim të profesionit të mjekut në kundërshtim me ligjin, si dhe aspekte të ndryshme të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe organizimit spitalor, veçanërisht në një sektor shumë sensitiv sikurse janë shërbimet e onkologjisë, Komisioneri rekomandon MSHMS, që të ushtrojë kompetencat e saj për të verifikuar dhe audituar pretendimet për paligjshmëri të paraqitura nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa “a” dhe nenin 33, pika 10, 11 e 12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses F.K nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si pasojë e mostrajtitim efektiv të pretendimeve/ankimit për diskriminim në vendin e punës.

2. Në referim të pikës 1 të Vendimit, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” duhet të marrë masa:
 - 2.1 Për të trajtuar në mënyrë efektive, pretendimet/ankimin për diskriminim të paraqitur nga ankuesja F.K , përfshi ankimin kundër urdhrit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Nr.556, datë 25.11.2024 *“Për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinore/tumor-bordeve në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”*.
 - 2.2 Për të rishikuar rregulloret dhe aktet e saj të brendshme në mënyrë që ato të parashikojnë procedura konkrete për trajtimin e ankesave për diskriminim që paraqiten nga punëmarrësi.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses F.K nga ana Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. Rekomandohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që në ushtrim të kompetencave të saj monitoruese, mbikëqyrëse dhe audituese, të verifikojë pretendimet për paligjshmëri në Shërbimin Onkologjik, në Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA